



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Rr. Sheshi i Lirisë, p.n. Fushë Kosovë 12000, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosove SH.A

Deklaratë për Media

Raporti i fundit i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) ka ngritur shqetësime serioze lidhur me dobësitë e identifikuara në menaxhimin e kontratës "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit" të nënshkruar me datën 30.09.2021, pra në kohën kur KMDK është udhëhequr nga menaxhmentit të mëparshëm. Si kryeshef ekzekutiv aktual i KMDK-së, dua të siguroj publikun dhe të

Pas raportit të ZKA-së Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë për Menaxhimin e Deponive, jep detaje mbi masat korrigjuese që janë ndërmarrë në bashkëpunim edhe me organet e hetuesisë

Kryeshefi i Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) Dardan Velija nëpërmjet një komunikate për media ka informuar publikun lidhur me raportin e fundit të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA), që ka ngritur shqetësime për dobësitë e identifikuar në menaxhimin e kontratës "Mirëmbajtja dhe Riparimi i Infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit", të nënshkruar më 30.09.2021, gjatë udhëheqjes së administratës së mëparshme.

Si kryeshef ekzekutiv i KMDK-së, Dardan Velija siguroi publikun dhe të gjitha palët e interesuara se këto çështje janë duke u trajtuar me seriozitet të plotë dhe tashmë janë ndërmarrë veprime korrigjuese për të adresuar shqetësimet e ngritura.

"Menaxhimi i duhur i kontratave dhe transparenca financiare janë parime kyçe për organizatën tonë. Edhe pse ky auditim ka të bëjë me një kontratë që është nënshkruar dhe zbatuar nga administrata e mëparshme, si udhëheqës i kësaj ndërmarrjeje, marr përgjegjësinë për të siguruar që reformat e nevojshme dhe masat e llogaridhënies të zbatohen pa vonesë," thuhet ndër të tjera në komunikatë.

Në raportin e ZKA-së janë evidentuar tejkalimi i disa pozicioneve dhe mos shfrytëzimi i pozicioneve të tjera financiare, si dhe tejkalime të sasive të kontraktuara dhe pagesa të paautorizuara në një shumë prej 958,189 €. Mospërputhje me ligjin e prokurimit: përfshirë devijime kontraktuale që kanë tejkaluar kufirin ligjor prej 30% sipas kontratës dhe lënie pa shfrytëzuar të shumicës së linjave të kontraktuara. Mungesë dokumentacioni dhe mbikëqyrje të duhur: Kjo ka ngritur shqetësime serioze për transparencën financiare dhe mundësitë për keqpërdorim dhe korrupsion. Mungesë miratimesh dhe kontrollesh të nevojshme.

Për të gjitha këto kryeshefi i KMDK-së, Dardan Velija ka thënë se janë duke u ndërmarrë veprimet nevojshme në çështje si:

Rishikimi i brendshëm i menaxhimit: Po ristrukturojmë ndërmarrjen dhe po vëmë rend dhe rregull në prokurim dhe menaxhim të kontratave, për të siguruar që të gjitha kontratat të jenë në përputhje me procedura të qarta dhe konkurruese.

gjithë palët e interesuara se këto çështje po trajtohen me seriozitet të plotë, dhe tashmë janë ndërmarrë veprime korrigjuese.

Është e rëndësishme të qartësohet se gjetjet në këtë raport kanë të bëjnë me një kontratë që është nisur dhe zbatuar nga administrata e mëparshme, përpara se unë të merrja këtë pozitë. Megjithatë, si udhëheqës i kësaj organizate, marr përgjegjësinë e plotë për të siguruar që reformat e nevojshme dhe masat e llogaridhënies të zbatohen menjëherë.

Çështjet Kryesore të Identifikuara në Raportin e Auditimit:

- Dobësi në realizimin e kontratës - tejkalmi i disa pozicioneve dhe mos shfrytëzimi i pozicioneve tjera financiare. Tejkalimet e sasive të kontraktuara dhe pagesa të paautorizuara, në një shumë prej 958,189 €.
- Mospërputhje me ligjin e prokurimit, duke përfshirë devijime kontraktuale që kanë tejkaluar kufirin ligjor prej 30% sipas kontratës dhe lënie pa shfrytëzuar të shumicës së linjave të kontraktuara.
- Mungesë dokumentacioni dhe mbikëqyrjeje të duhur, duke ngritur shqetësime serioze për transparencën financiare dhe mundësi për keqpërdorim dhe korrupsion.
- Mungesë e miratimeve dhe kontrolleve të nevojshme.

Veprimet që po ndërmarrim:

- **Rishikim i menjëhershëm i brendshëm**
 - Po rristrukturojmë ndërmarrjen dhe po vëmë rend dhe rregull në prokurim dhe menaxhim të kontratave, për të siguruar që të gjitha kontratat të jenë në pajtim me procedura të qarta, të hapura dhe konkurruese.
 - Si ekip menaxhues po merremi me këtë çështje, dhe po kryejmë një rishikim të plotë të praktikave të mëparshme financiare dhe të menaxhimit të kontratave.
 - Po bashkëpunojmë ngushtë me këshilltarë ligjorë për të shqyrtuar nëse duhet të ndërmerren veprime ligjore kundër atyre që janë përgjegjës për shkelje, brenda dhe jashtë ndërmarrjes.
 - Po shqyrtojmë mundësitë e rritjes së mbikëqyrjes dhe llogaridhënies nepërmjet angazhimit të një auditori shtesë dhe të një mbështetësi profesional për menaxhimin e kontratave.
 - Po zbatojmë procese më të rrepta miratimi për të gjitha kontratat, për të parandaluar shpenzimet e paautorizuara apo të panevojshme.
 - Po vendosim një kuadër të ri të pajtueshmërisë në prokurim, për të siguruar që të gjitha kontratat të jenë në pajtim me procedura të qarta, të hapura dhe konkurruese.
- **Bashkëpunim i plotë me autoritetet**
 - Po bashkëpunojmë plotësisht me ZKA dhe çdo institucion hetimor përkatës.

- KMDK do të sigurojë të gjithë dokumentacionin dhe provat e nevojshme për një hetim të thellë dhe të drejtë për parregullsitë e identifikuar.
- **Mbajtja përgjegjëse e atyre që janë përfshirë**
 - Kemi vendosur të suspendojmë përgjegjësit e nivelit të parë të identifikuar për parregullsitë.
 - Për këdo që konfirmohet keqbërje, do të ndërmarrim veprime ligjore për të rikuperuar fondet e keqpërdoruara.
 - Po rishikojmë detyrimet kontraktuale dhe përgjegjësitë ligjore, për të përcaktuar nëse ish-zyrtarët kanë shkelur detyrat e tyre.
- **Sigurimi i transparencës dhe reformave afatgjata**
 - Po implementojmë një sistem dixhital të monitorimit, për të garantuar mbikëqyrje financiare në kohë reale.
 - Jemi duke e përmirësuar procesin e brendshëm dhe kualitetin e raportimit, për të informuar mbi përparimet në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit financiar në ndërmarrje.
 - Punonjësit e përfshirë në prokurim, menaxhim të kontratave dhe mbikëqyrjes financiare do t'i nënshtrohen trajnimeve të detyrueshme mbi etikën dhe pajtueshmërinë ligjore.
- **Angazhimi ynë për transparencë dhe besimin publik**

KMDK është e përkushtuar për të rikthyer besimin e publikut përmes masave më të forta të llogaridhënies, kontrolleve financiare dhe lidërshpit etik. Kjo situatë nuk do të injorohet dhe nuk do të përsëritet nën udhëheqjen time.

Ne do të informojmë publikun mbi përparimet tona dhe të sigurohemi që të gjitha masat korrigjuese të zbatohen me rigorozitet.

Qëllimi ynë është ta transformojmë KMDK-në në një model të transparencës dhe efikasitetit, duke garantuar që fondet publike të menaxhohen me përgjegjësi dhe në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim, ju ftojme të na kontaktoni. Ne mbetemi të përkushtuar për të zgjidhur këtë çështje me transparencë dhe përgjegjësi të plotë.

Raportin e plotë: “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në deponitë sanitare dhe stacionet e transferit në Kompaninë e Menaxhimit të Deponive në Kosovë” mund ta gjeni në: <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=7972>

Dardan Velija
Kryeshef Ekzekutiv

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë

Rruga: Sheshi i Lirisë, p.n Fushë Kosovë 12000, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552

Email: info@kmdk-ks.org